



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES
SË KONSUMATORIT
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME



Nr. 988/1 Prot.

Tiranë, më 30/05 /2012

Lënda: Dërgim i Urdhërit Nr. 168 dt. 24.05.2012

Drejtuar: Drejtorive Rajonale të AKU

Tiranë
Durrës
Vlorë
Dibër
Fier
Elbasan
Berat
Gjirokastrë.
Korçë
Lezhë
Shkodër
Kukës

Bashkangjitur po ju dërgojmë Urdhërin e Ministrit Nr. 168 datë 24.05.2012 “Mbi miratimin e pikave të inspektimit kufitar, ku kryhet inspektimi veterinar, fitosanitar dhe i ushqimit për njerëz dhe kafshë në Republikën e Shqipërisë”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

GENC JUKA





Nr. Prot. 988
Datë 25/05.2012

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
MINISTRI

Nr. 2351 Prot.

Tiranë, më 24/5 /2012

U R D H Ë R

Nr. 168 Datë 24.5 2012

MBI

MIRATIMIN E PIKAVE TË INSPEKTIMIT KUFITAR, KU KRYHET
INSPEKTIMI VETERINAR, FITOSANITAR DHE I USHQIMIT PËR NJERËZ
DHE KAFSHË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISE

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, nenin 33 pika 4, të Ligjit nr.10465, datë 29.09.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë", nenin 16 pika 3, të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 "Për Ushqimin" dhe nenin 13 të Ligjit nr.9362 datë 24.03.2005 "Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve",

U R D H Ë R O J:

1. Ngarkesat e kafshëve të gjalla, ushqimeve me origjinë shtazore dhe jo shtazore, produkteve me origjinë shtazore, ushqimeve për kafshë, produkteve mjeksore veterinare, bimëve, produkteve bimore si dhe të objekteve të tjera në kuptim të ligjit nr.9362 datë 24.03.2005 "Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve", hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, vetëm nëpërmjet Pikave të Inspektimit Kufitar (PIK) dhe në të gjitha rastet, janë objekt i inspektimeve përkatëse.

2. Pikat e Inspektimit Kufitar në të cilat kryhet inspektimi veterinar, inspektimi fitosanitar dhe inspektimi ushqimor për ushqimet për njerëz dhe kafshë, sipas pikës 1 të këtij Urdhëri janë në pikat e kalimit kufitar si më poshtë:

- Aeroporti "Nënë Tereza" Rinas, Tiranë;
- Porti detar, Durrës;
- Porti detar, Vlorë;
- Hani i Hotit, Shkodër;
- Morinë, Kukës;
- Qafë Thanë, Pogradec;
- Kapshticë, Korçë;

- Kakavijë, Korçë;
- Porti Shëngjin, Lezhë;
- Blladë, Dibër.

3. Inspektimi fitosanitar dhe inspektimi ushqimor për ushqimet për njerëz dhe kafshë, me origjinë shtazore dhe jo shtazore, të kryhet vetëm me njoftim paraprak në PIK:

- Goricë, Korçë;
- Qafë Botë, Sarandë;
- Qafë Morinë, Tropojë.

4. Inspektimet sipas pikës 3 të kryhen nga inspektorët fitosanitarë dhe nga inspektorët e ushqimit për njerëz dhe kafshë, të Drejtorive Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit të Korçës, Vlorës dhe Kukësit.

5. Urdhëri nr.6, datë 25.01.2011 “Mbi miratimin e pikave të kontrollit kufitar, ku kryhet inspektimi veterinar, fitosanitar dhe i ushqimit për njerëz dhe kafshë, në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.

6. Për zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohen Drejtoria e Sigurisë Ushqimore, Drejtoria e Shërbimeve Veterinare dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

